

URDHËR
Nr. 169, datë 13.12.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË VETME TË SIGURISË PËR SIPËRMARRJET HEKURUDHORE”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 60, pika 2 dhe pika 4, shkronja “b” dhe nenit 65, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore dhe sipërmarrjet hekurudhore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE

PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË VETME TË SIGURISË PËR SIPËRMARRJET HEKURUDHORE¹

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave praktike që duhen zbatuar nga sipërmarrjet hekurudhore kur dorëzojnë aplikime dhe nga organet e certifikimit të sigurisë kur vlerësojnë aplikimet, për certifikata të vetme sigurie, për rinovimin ose përditësimin e këtyre certifikatave, si dhe koordinimin e Autoritetit Kombëtar të Sigurisë, më poshtë Autoriteti me Agjencinë Evropiane të Hekurudhave, më poshtë Agjencia.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Organ certifikimi i sigurisë” nënkupton organin përgjegjës për lëshimin e një certifikate të vetme sigurie, Autoriteti ose Agjencia;

2. “Data e marrjes së aplikimit” do të thotë:

a) dita e parë e punës e Autoritetit, kur vepron ai si organ certifikimi i sigurisë; ose

b) kur Agjencia vepron si organi i certifikimit të sigurisë, ditën e parë të punës së përbashkët për Agjencinë dhe për Autoritetin, pas konfirmimit të marrjes së dosjes së aplikimit;

3. “Para-angazhim” është një fazë procedurale që i paraprin dorëzimit të një aplikimi, gjatë së cilës aplikanti mund të kërkojë informacion shtesë mbi fazat vijuese të procesit të vlerësimit të

¹Kjo rregullore përfaqëson plotësisht me Rregulloren e Komisionit (BE) 2018/763, e datës 9 prill 2018, “Vendosja e rregullave praktike për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore, në përputhje me Direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizimi i Rregullore së Komisionit (EC) nr. 653/2007”, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, 32018R0763, seria L 129/49, datë 25.5.2018.

sigurisë nga organi i certifikimit të sigurisë;

4. “Shqetësim i mbetur” do të thotë një çështje e identifikuar gjatë vlerësimit të një aplikimi për një certifikatë të vetme sigurie, e cila nuk pengon lëshimin e saj dhe mund të shtyhet për mbikëqyrje të mëvonshme.

Neni 3

Përgjegjësitë e organit të certifikimit të sigurisë

1. Përveç lëshimit të certifikatave të vetme të sigurisë, organi i certifikimit të sigurisë është përgjegjës për këto detyra:

- a) planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e punës së vlerësimit që kryen;
- b) vendosjen e marrëveshjeve të koordinimit ndërmjet palëve përkatëse.

2. Organi i certifikimit të sigurisë pranon para-angazhimin me kërkesë të aplikantit dhe japin çdo sqarim të kërkuar nga aplikanti në kontekstin e para-angazhimit.

3. Për qëllimet e lëshimit të certifikatave të vetme të sigurisë, organi i certifikimit të sigurisë përpilon informacionin e mëposhtëm:

a) të gjithë informacionin përkatës në lidhje me fazat e ndryshme të vlerësimit, duke përfshirë arsyet për vendimet e marra gjatë vlerësimit dhe identifikimin e çdo kufizimi ose kushti përdorimi që do të përfshihet në certifikatën e vetme të sigurisë;

b) rezultatin e vlerësimit, duke përfshirë konkluzionet përmbledhëse dhe aty ku është e përshtatshme, një opinion në lidhje me lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë.

4. Organi i certifikimit të sigurisë publikon dhe mban të përditësuar një udhëzues aplikimi, pa pagesë, duke përshkruar dhe kur është e nevojshme duke shpjeguar kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe rregullat procedurale kombëtare.

5. Agjencia monitoron datat e skadencës së të gjitha certifikatave të vetme të vlefshme të sigurisë me një zonë operimi në më shumë se një shtet dhe ndan atë informacion me autoritetet përkatëse kombëtare të sigurisë.

6. Autoriteti ndan me Agjencinë dhe autoritetet e tjera kombëtare të sigurisë, që lidhen me zonën e synuar të operimit, të gjithë informacionin përkatës që mund të ketë ndikim në procesin e vlerësimit të sigurisë.

7. Autoriteti, në zbatim të nenit 65, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, vendos rregullime ose procedura të brendshme për administrimin e procesit të vlerësimit të sigurisë dhe njofton Agjencinë.

8. Çdo certifikatë të vetme sigurie i vendoset një numër unik Identifikimi Evropian (EIN) sipas përcaktimit të bërë nga Agjencia dhe janë të disponueshme në faqen e saj të internetit.

9. Në rastet e operimit në stacione afër kufirit me shtetet fqinje, me karakteristika të ngjashme rrjeti dhe rregullash hekurudhore, certifikata e vetme e sigurisë është e vlefshme pa kërkuar një zgjerim të zonës së operimit me kusht që, autoritetet kombëtare të sigurisë të shteteve përkatëse, janë konsultuar më parë dhe kanë konfirmuar se rregullat kombëtare dhe detyrimet në lidhje me marrëveshjet përkatëse ndërkufitare janë përmbushur, përpara lëshimit të certifikatës së vetme të sigurisë.

10. Organi i certifikimit të sigurisë, për qëllime të vlerësimit të aplikimeve, pranon autorizimet, njohjet ose certifikatat e produkteve, ose shërbimeve të ofruara nga sipërmarrjet hekurudhore ose kontraktorët, partnerët ose furnizuesit e tyre, të dhëna si provë të aftësisë së sipërmarrjeve hekurudhore për të përmbushur kërkesat përkatëse të sigurisë.

Neni 4

Përgjegjësitë e aplikantëve

1. Pa cenuar afatin kohor të lejuar për vlerësimin e përcaktuar në nenin 6, aplikanti duhet të paraqesë kërkesën për një certifikatë të vetme sigurie, për përditësimin ose rinovimin e saj, sipas rastit:

- a) datën e planifikuar të fillimit të çdo operacioni të ri të transportit hekurudhor;
- b) datën e planifikuar të fillimit të një operacioni transporti hekurudhor në kushte të ndryshme nga

ato të përcaktuara në certifikatën e vetme aktuale të sigurisë, pas një ndryshimi thelbësor të bërë në llojin, shtirjen ose zonën e operimit;

c) data e skadencës së certifikatës aktuale të vetme të sigurisë.

2. Kur dorëzon një aplikim për një certifikatë të re të vetme sigurie, aplikanti duhet të sigurojë informacionin e renditur në aneksin I.

3. Kur dorëzon një aplikim për përditësimin ose rinovimin e një certifikate të vetme sigurie, aplikanti duhet të sigurojë informacionin e renditur në aneksin I dhe të përshkruajë ndryshimet e bëra që nga lëshimi i certifikatës aktuale.

Nëse gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes, që nga vlerësimi i mëparshëm, identifikohen mospërputhje të mëdha, të cilat mund të ndikojnë në performancën e sigurisë ose të krijojnë rreziqe serioze për sigurinë, ose ndonjë fushë tjetër shqetësuese, organi certifikues i sigurisë vendos nëse e gjithë dosja e aplikimit duhet të rivlerësohet.

4. Përzgjedhja e organit të certifikimit të sigurisë, e bërë nga aplikanti, është e detyrueshme derisa të përfundojë procesi i vlerësimit të sigurisë.

5. Kur aplikanti kërkon angazhim paraprak, ai dorëzon informacionin e renditur në pikat 1 deri në 6, të shtojcës I.

6. Aplikanti duhet të ruajë origjinalet e dokumenteve të lëshuara nga subjekte të ndryshme nga organi i certifikimit të sigurisë, për të paktën 5 vjet pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë dhe këto dokumente origjinale, duhet të jenë të gatshme për t'u dorëzuar në rast kërkesash të Autoriteti ose Agjencia.

Neni 5

Gjuha

1. Kur Agjencia vepron si organ certifikues i sigurisë, gjuha që përdoret për aplikimin është si më poshtë:

a) për pjesën e dosjes së aplikimit të përmendur në shkronjën “a”, të nenit 65, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian sipas zgjedhjes së aplikantit;

b) për pjesët e dosjes së aplikimit të përmendura në shkronjën “b”, të nenit 65, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe për pjesët e dosjes së aplikimit të përmendura në pikën 8.1, të aneksit 1, gjuha e përcaktuar nga shteti anëtar në fjalë dhe e treguar në udhëzuesin e aplikimit të përmendur në nenin 3, pika 8 të kësaj rregulloreje.

2. Çdo vendim në lidhje me lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë të marrë nga Agjencia, duke përfshirë arsyet e vendimit në rezultatin përfundimtar të vlerësimit dhe kur është e zbatueshme, certifikatën e vetme të sigurisë, do të jetë në gjuhën e përmendur në pikën “a”, të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 6

Fazat dhe afatet procedurale

1. Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë, që lidhen me zonën e synuar të operimit, zbatojnë procesin e përcaktuar në aneksin 2.

2. Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë, që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit, do të vlerësojnë, secili për pjesën e vet, nëse dosja e aplikimit përmban dokumentet e kërkuara në aneksin 1. Organi i certifikimit të sigurisë duhet të informojë aplikantin, pa vonesa të panevojshme dhe në çdo rast jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së aplikimit, nëse aplikimi është i plotë.

3. Vendimi për lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë merret jo më vonë se katër muaj pas datës në të cilën është bërë regjistrimi i aplikimit, në përputhje me paragrafët 5 deri në 7.

4. Nëse aplikanti informohet se dosja e tij nuk është e plotë, organi i certifikimit të sigurisë, në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë të interesuara me zonën e synuar të operimit, do të kërkojë menjëherë informacionin e nevojshëm plotësues, duke përfshirë arsyetimet dhe detajet e

kornizës kohore për përgjigjen e aplikantit.

Afati kohor për dhënien e informacionit plotësues duhet të jetë i arsyeshëm, në përpjesëtim me vështirësinë e dhënies së informacionit të kërkuar dhe të rënë dakord me aplikantin sapo të informohet se dosja e tij nuk është e plotë. Nëse aplikanti nuk jep informacionin e kërkuar brenda kornizës kohore të rënë dakord, organi i certifikimit të sigurisë mund të vendosë të zgjasë afatin kohor për përgjigjen e aplikantit ose të njoftojë aplikantin se aplikimi i tij është refuzuar.

Vendimi për lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë do të merret jo më vonë se katër muaj pas datës në të cilën kërkuesi dorëzon informacionin plotësues të kërkuar.

5. Edhe nëse dosja e aplikimit është e plotë, Agjencia ose çdo autoritet kombëtar i sigurisë, i lidhur me zonën e synuar të operimit, mund të kërkojë informacion të mëtejshëm, në çdo kohë, përpara marrjes së vendimit të saj dhe do të caktojë një afat të arsyeshëm për dhënien e tij. Një kërkesë e tillë do të zgjasë afatin kohor të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, sipas kushteve të përcaktuara në aneksin 2.

6. Afati kohor në paragrafin 3 të këtij neni mund të zgjatet nga Agjencia për periudhat e mëposhtme:

a) periudha e bashkëpunimit me synimin për të rënë dakord për një vlerësim reciprokisht të pranueshëm;

b) periudha kur çështja i referohet Bordit të Apelit për arbitrazh pranë Agjencisë.

7. Afati mund të zgjatet gjithashtu për kohën e nevojshme që aplikanti të organizojë një vizitë ose inspektim në vendet e tij, ose një auditim të organizatës së tij.

8. Certifikata e vetme e sigurisë duhet të përmbajë informacionin e renditur në aneksin 3.

Neni 7

Komunikimi

1. Organi i certifikimit të sigurisë, autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit dhe aplikanti do të komunikojnë nëpërmjet *one-stop-shop* për çdo çështje të përmendur në nenin 12.

2. Statusi i të gjitha fazave të procesit të vlerësimit të sigurisë, rezultati i vlerësimit dhe vendimi për aplikimin i komunikohen aplikantit nëpërmjet *one-stop-shop*.

3. Pa cenuar paragrafin 1, udhëzuesit e aplikimit të Agjencisë dhe Autoritetit do të tregojnë masat për komunikimin ndërmjet tyre dhe me aplikantin.

4. *One-stop-shop* konfirmon marrjen e kërkesës për një certifikatë të vetme sigurie.

Neni 8

Periudha e vlefshmërisë së certifikatave të vetme të sigurisë

Certifikatat e vetme të sigurisë do të jenë të vlefshme për një periudhë pesëvjeçare.

Megjithatë, nëse një periudhë më e shkurtër është e nevojshme për të siguruar kontrollin efektiv të rreziqeve që ndikojnë në sigurinë e operacioneve hekurudhore, organi i certifikimit të sigurisë mund të vendosë, në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë të interesuara me zonën e synuar të operimit, të japë certifikatën e vetme të sigurisë, për një periudhë më pak se pesë vjet. Në këtë rast, organi i certifikimit të sigurisë përfshin arsyet e vendimit të tij në rezultatin e vlerësimit të regjistruar në përputhje me nenin 9.

Neni 9

Administrimi i informacionit

Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë, të lidhura me zonën e synuar të operimit, regjistrojnë të gjithë informacionin përkatës dhe rezultatin e vlerësimit të përmendur në nenin 3, pika 3, të rregullores në *one-stop-shop*. Agjencia regjistron gjithashtu rezultatin përfundimtar të vlerësimit të përmendur në nenin 3, pika 4 në *one-stop-shop*.

Kur Autoriteti përdor një sistem të administrimit të informacionit për përpunimin e

aplikacioneve që u drejtohen atij, ai do të transferojnë të gjithë informacionin përkatës në *one-stop-shop*.

Neni 10

Marrëveshjet për vizita dhe inspektime në vendet e sipërmarrjeve hekurudhore dhe auditime

1. Gjatë kryerjes së vizitave dhe inspektimeve në vendet e aplikantëve dhe auditimeve, në zbatim të nenit 65, pika 5, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, objektivat dhe qëllimi i këtyre vizitave dhe inspektimeve në vendet e aplikantëve dhe auditimeve, do të koordinohen ndërmjet Agjencisë dhe Autoritetit.

2. Organi përgjegjës për kryerjen e vizitës, inspektimit ose auditimit duhet të hartojë një raport, duke identifikuar çështjet gjatë vlerësimit dhe duke specifikuar nëse ato janë mbyllur nga provat e ofruara gjatë vizitës, inspektimit ose auditimit dhe, nëse po, si. Ai raport mund të përfshijë gjithashtu çështje shtesë të përmendura në nenin 12 për t’u zgjidhur nga aplikanti brenda një afati kohor të rënë dakord.

3. Aplikanti gjatë kryerjes së vizitave dhe inspektimeve duhet të japë detaje se kush do ta përfaqësojë atë dhe rregullat, dhe procedurat e sigurisë në terren që duhet të respektohen nga organi përgjegjës për kryerjen e vizitës, inspektimit ose auditimit. Afati kohor për vizitat, inspektimet dhe auditimet, duke përfshirë dhënien e informacionit të përmendur më sipër, do të bihet dakord ndërmjet organit përgjegjës dhe aplikantit.

Neni 11

Koordinimi ndërmjet Agjencisë dhe autoriteteve kombëtare të sigurisë

1. Kur vepron si organ certifikues, Agjencia koordinon me autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit në fazat e ndryshme të procesit të vlerësimit të sigurisë. Agjencia dhe autoritetet kombëtare të sigurisë diskutojnë çdo çështje, në lidhje me procesin e vlerësimit të sigurisë, duke përfshirë çdo mangësi dhe çdo kërkesë për informacion shtesë që ndikojnë në punën e autoriteteve të tjera kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e operimit.

2. Pa paragjykuar paragrafin 1, çdo organ i përfshirë në procesin e vlerësimit të sigurisë mund të kontaktojë drejtpërdrejt me aplikantin, në lidhje me çështjet që lidhen me pjesën e tij të vlerësimit.

3. Përpara se të vendosin për lëshimin e një certifikate të vetme sigurie, Agjencia dhe autoritetet kombëtare të sigurisë, që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit, do të ndërmarrin hapat e mëposhtëm:

- a) diskutojnë rezultatet e vlerësimeve të tyre përkatëse;
- b) bien dakord për çdo shqetësim të mbetur që do të shtyhet për shqyrtim gjatë mbikëqyrjes së mëvonshme;
- c) bien dakord për çdo kufizim ose kusht përdorimi që do të përfshihet në certifikatën e vetme të sigurisë.

4. Kur aplikanti krijon një plan veprimi për të adresuar shqetësimet e mbetura, të përmendura në shkronjën “b”, të paragrafit 3, autoritetet kombëtare të sigurisë bien dakord se cili prej tyre do të ndjekë përfundimin e tij. Për këtë qëllim, autoritetet kombëtare të sigurisë do të koordinojnë aty ku është e nevojshme, në përputhje me marrëveshjet e përmendura në nenin 71, pika 4, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe informojnë Agjencinë për marrëveshjen e tyre dhe rezultatit e aktivitetet e tyre të mbikëqyrjes përkatëse.

5. Agjencia merr parasysh informacionin mbi rezultatit e aktivitetet të mbikëqyrjes të kryera nga autoritetet kombëtare të sigurisë, në lidhje me zonën e synuar të operimit, në lidhje me ndjekjen e shqetësimeve të mbetura, për të vendosur nëse këto mund të mbyllen gjatë vlerësimit të aplikimit të përditësimit ose rinovimit.

6. Agjencia mban evidencë për aktivitetet e koordinimit dhe i regjistron ato në *one-stop-shop*, në

pajtim me nenin 9.

Neni 12

Kategorizimi i çështjeve

1. Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë të lidhura me zonën e synuar të operimit i kategorizojnë çështjet e identifikuarat gjatë vlerësimit të dosjes së aplikimit, si më poshtë:

- a) “Tipi 1” çështje që kërkojnë përgjigje nga aplikanti për të kuptuar dosjen e aplikimit;
- b) “Tipi 2” çështje që mund të çojnë në një ndryshim të dosjes së aplikimit ose në veprime të vogla nga aplikanti; veprimi që do të ndërmerret lihet në gjykimin e aplikantit dhe nuk pengon lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë;
- c) “Tipi 3” çështjet që kërkojnë që aplikanti të ndërmarrë veprime specifike, përfundimi i të cilave mund të shtyhet deri pas dhënies së certifikatës së vetme të sigurisë; veprimi për zgjidhjen e një çështjeje do të propozohet nga aplikanti dhe do të bihet dakord me palën që e ka identifikuar çështjen;
- d) “Tipi 4” çështje që kërkojnë një ndryshim të dosjes së aplikimit ose një veprim specifik që duhet të ndërmerret nga aplikanti; certifikata e vetme e sigurisë nuk do të jepet nëse çështja zgjidhet ose nuk përfshihen kufizime ose kushte përdorimi në certifikatë për të adresuar çështjen; çdo veprim për të zgjidhur një çështje do të propozohet nga aplikanti dhe do të bihet dakord me palën që e ka identifikuar çështjen.

2. Pas përgjigjes ose veprimit të ndërmarrë nga aplikanti sipas çështjes, organi i certifikimit të sigurisë ose autoriteti në fjalë rivlerëson çështjet që ka identifikuar, i riklasifikon ato aty ku është e nevojshme dhe cakton një nga statutet e mëposhtme për secilën nga çështjet e identifikuarat:

- a) “Çështja në pritje” nëse provat e ofruara nga aplikanti nuk janë të kënaqshme dhe kërkohen ende informacione shtesë;
- b) “Shqetësim i mbetur për mbikëqyrje” nëse një shqetësim i mbetur ende ekziston;
- c) “Çështja u mbyll” nëse është dhënë një përgjigje e përshtatshme e aplikantit dhe nuk mbetet asnjë shqetësim i mbetur.

Neni 13

Kompetenca e personelit të përfshirë në vlerësime

1. Agjencia dhe Autoriteti sigurojnë që personeli i përfshirë në vlerësime të ketë kompetencat e mëposhtme:

- a) njohja e kuadrit rregullator përkatës, siç zbatohet për vlerësimin;
- b) njohuri për funksionimin e sistemit hekurudhor;
- c) niveli i duhur i analizës kritike;
- ç) përvojë në vlerësimin e një sistemi të menaxhimit të sigurisë ose të ngjashëm në sektorin hekurudhor, ose të një sistemi të menaxhimit të sigurisë në një sektor me sfida ekuivalente operationale dhe teknike;
- d) zgjidhja e problemeve, komunikimi dhe puna ekipore;
- dh) çdo kompetencë tjetër e kërkuar nga një vlerësim i caktuar.

2. Në rastin e punës në ekip, kompetencat mund të ndahen ndërmjet anëtarëve të ekipit.

3. Stafit që kryen vizita, inspektime dhe auditime, të përmendura në nenin 10 të rregullores, duhet të demonstrojnë gjithashtu njohuri dhe përvojë në aftësitë e intervistimit.

4. Me synimin për të siguruar zbatimin e saktë të paragrafit 1, Agjencia dhe Autoriteti vendosin një sistem të administrimit të kompetencave, i cili përfshin:

- a) zhvillimin e profileve të kompetencave për çdo punë, pozicion ose rol;
- b) rekrutimi i personelit në përputhje me profilet e përcaktuara të kompetencave;
- c) mirëmbajtjen, zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencës së personelit, në përputhje me profilet e përcaktuara të kompetencave.

Neni 14

Rishikimi i vendimit të refuzimit

1. Kur Autoriteti lëshon një vendim negativ, i cili përfshin refuzimin e certifikatës së vetme të sigurisë apo përjashtimin e një pjese të rrjetit, në përputhje me nenin 26, pika 3 dhe nenin 65, pika 4, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, aplikanti kërkon rishikimin e vendimit brenda një muaji nga marrja e vendimit.

2. Kërkesa për rishikim duhet të dorëzohet nga aplikanti përmes *one-stop-shop* dhe të përfshijë një listë të çdo çështjeje që, sipas kërkesës, nuk është shqyrtuar siç duhet gjatë procesit të vlerësimit të sigurisë.

3. Çdo informacion plotësues i dhënë pas miratimit të vendimit për lëshimin ose refuzimin e një certifikate të vetme të sigurisë nuk do të pranohet si provë.

4. Autoriteti, në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë, që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit, duhet të sigurojë paanshmërinë e procesit të rishikimit.

5. Procesi i rishikimit synon çështjet që justifikojnë devijimin e vendimit të organit të certifikimit të sigurisë nga kërkesa e aplikantit.

6. Kur Agjencia vepron si organi i certifikimit të sigurisë, rishikimi kryhet në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit.

7. Organi i certifikimit të sigurisë, brenda një afati jo më shumë se 2 muaj nga data e marrjes së kërkesës për shqyrtim, u komunikon vendimin e tij për të konfirmuar ose për të përshtatur vendimin fillestar të gjitha palëve të përfshira në vlerësim, duke përfshirë aplikantin, nëpërmjet shërbimit *one-stop-shop*.

Neni 15

Periudha tranzitore

1. Kur Autoriteti pranon se nuk është në gjendje të lëshojë një certifikatë sigurie përpara afatit të përcaktuar, ai duhet të informojë menjëherë aplikantin dhe Agjencinë.

2. Në rastet kur kryhet veprimtari hekurudhore në stacionet me shtetet fqinje, me karakteristika të ngjashme të rrjetit dhe rregulla të ngjashme pune, kur këto stacione janë në afërsi të kufirit, aplikanti vendos nëse aplikimi duhet të vazhdojë të vlerësohet nga Autoriteti ose t'i transferohet Agjencisë. Aplikanti duhet të informojë të dy dhe do të zbatohet procedurat si vijon:

a) Në rastet kur aplikanti ka vendosur të përdorë Agjencinë si organ certifikues të sigurisë, Autoriteti transferon dosjen e aplikimit dhe rezultatet e vlerësimit. Agjencia dhe Autoriteti bashkëpunojnë dhe ndihmojnë aplikantin për të plotësuar aplikimin, në mënyrë që të plotësojë kërkesat e nenit 64, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

b) Në rastet kur aplikanti ka vendosur të përdorë Autoritetin si organ certifikues të sigurisë, ai do të vazhdojë vlerësimin e aplikimit dhe do të vendosë për lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë, në përputhje me nenin 65, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe këtë rregullore. Autoriteti ndihmon aplikantin të plotësojë aplikimin.

3. Në rastin e një aplikanti që synon të operojë në më shumë se një shtet, ku stacionet janë larg kufirit, organ i certifikimit të sigurisë do të jetë Agjencia dhe zbatohet procedura e përcaktuar në pikën “a”, të paragrafit 2.

4. Sipërmarrjet hekurudhore të pajisura me licencë për leje veprimtarie të transportuesve hekurudhorë, në zbatim të VKM-së nr. 657, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e autoritetit licencues hekurudhor”, duhet të dorëzojnë një aplikim të ri për një certifikatë të vetme sigurie përmes *one-stop-shop*, në përputhje me këtë rregullore, brenda një periudhë prej 36 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të rregullores.

5. Në rastet e përmendura në pikën “a”, të paragrafit 2, Autoriteti bashkëpunon dhe koordinon me Agjencinë për të ndërmarrë vlerësimin e elementeve të përcaktuara në nenin 64, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

ANEKS I

Përmbajtja e aplikimit për një certifikatë të vetme sigurie

Shënim. I gjithë informacioni është i detyrueshëm, duke përfshirë dokumentet e bashkëngjitura aplikimit, përveç rasteve kur tregohet me 'O' (opsionale). Kur ndërmarja hekurudhore duhet të krijojë një plan veprimi korrigjues të përmendur në pikën 9, informacioni për të është i detyrueshëm.

1. Lloji i aplikimit:

- 1.1 I ri
- 1.2 Rinovim
- 1.3 Përditësim
- 1.4 EIN e certifikatës së mëparshme (vetëm në rast rinovimi ose përditësimi të aplikimit)

2. Lloji i operacionit të kërkuar (zgjidh një ose më shumë):

- 2.1 Transporti i pasagjerëve duke përfshirë shërbimet me shpejtësi të lartë
- 2.2 Transporti i pasagjerëve me përjashtim të shërbimeve me shpejtësi të lartë
- 2.3 Transport mallrash duke përfshirë shërbimet e mallrave të rrezikshme
- 2.4 Transport mallrash me përjashtim të shërbimeve të mallrave të rrezikshme
- 2.5 Vetëm shërbim devijimi
- 2.6 Të tjera (specifiko)

3. Operacionet e transportit hekurudhor:

- 3.1 Data e pritshme e fillimit të shërbimeve/operacioneve
- 3.2 Shtetet anëtare që kanë të bëjnë me zonën e synuar të veprimit
- 3.3 Përkufizimi i zonës së synuar të funksionimit (për rrjetet përkatëse)
- 3.4 Stacionet në shtetet anëtare fqinje, të përmendura në nenin 3, pika 9 dhe nenin 15, pika 2, të rregullores

4. Trupi certifikues i sigurisë:

- 4.1 Agjencia
- 4.2 Autoriteti Kombëtar i Sigurisë

5. Informacioni i aplikantit:

- 5.1 Emërtimi ligjor
- 5.2 Akronimi (O)
- 5.3 Adresa postare e plotë
- 5.4 Telefoni
- 5.5 Faks (O)
- 5.6 *Email*
- 5.7 Faqja e internetit (O)
- 5.8 Numri kombëtar i regjistrimit
- 5.9 Numri i TVSH-së
- 5.10 Informacione të tjera përkatëse (O)

6. Informacioni i personit të kontaktit:

- 6.1 Emri
- 6.2 Mbiemri
- 6.3 Titulli ose funksioni
- 6.4 Adresa postare e plotë
- 6.5 Telefoni
- 6.6 Faks (O)
- 6.7 *Email*
- 6.8 Gjuha ose gjuhët e folura

Dokumentet e bashkangjitura në aplikacion

7. Dokumentet e paraqitura për sistemin e menaxhimit të sigurisë pjesë e vlerësimit:

7.1 Përshkrimi i sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe dokumenteve të tjera që demonstrojnë përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në pikën 3, të nenit 65, të ligjit nr. 142, datë

22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe që tregojnë se si plotësohen këto kërkesa.

7.2 Informacioni që ndërlidh sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe tregon se janë plotësuar kërkesat përkatëse të specifikimit teknik për ndërveprueshmërinë, në lidhje me operimin dhe nënsistemin e administrimit të trafikut.

8. Dokumentet e dorëzuara për pjesën kombëtare të vlerësimit:

8.1 Përshkrim ose demonstrim tjetër se si rregullimet e menaxhimit të sigurisë trajtojnë rregullat përkatëse kombëtare, të njoftuara në përputhje me nenin 62, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

8.2 Informacion që ndërlidh sistemin e menaxhimit të sigurisë (shih pikën 7.1) kundrejt kërkesave të përcaktuara në rregullat përkatëse kombëtare (shih pikën 8.1).

9. Plan veprimi

9.1 Statusi aktual i planit të veprimit ose planeve të përcaktuara nga sipërmarrja hekurudhore për të zgjidhur çdo mospërputhje të madhe dhe çdo fushë tjetër shqetësimi të identifikuar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes që nga vlerësimi i mëparshëm.

9.2 Statusi aktual i planit të veprimit ose planeve të përcaktuara nga sipërmarrja hekurudhore për të zgjidhur shqetësimet e mbetura nga vlerësimi i mëparshëm.

ANEKS II

Procesi i vlerësimit të sigurisë

1. E përgjithshme

1.1 Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë, që lidhen me zonën e synuar të operimit, do të zhvillojnë një proces të strukturuar dhe të auditueshëm për aktivitetin e plotë, i cili merr parasysh elementet e përcaktuara në këtë aneks. Procesi i vlerësimit të sigurisë duhet të jetë i përsëritur, siç tregohet në figurën 1 më poshtë, dhe organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë kanë të drejtë të bëjnë kërkesa të arsyeshme të mëtejshme për informacion shtesë në përputhje me këtë rregullore.

2. Pranimi i aplikimit

2.1 Pas marrjes së aplikimit për një certifikatë të vetme sigurie, organi i certifikimit të sigurisë konfirmon zyrtarisht dhe menjëherë marrjen e aplikimit.

2.2 Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit caktojnë burime kompetente për të ofruar procesin e vlerësimit.

3. Vlerësimi fillestar

3.1 Organi i certifikimit të sigurisë në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë, që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit, ndërmarrin menjëherë pas marrjes së aplikimit një vlerësim fillestar për të kontrolluar elementet e mëposhtme:

a) aplikanti ka dhënë informacionin bazë që ose kërkohet nga legjislacioni ose i nevojshëm që ai të përpunohet në mënyrë efektive;

b) dosja e aplikimit përmban prova të mjaftueshme dhe është e strukturuar dhe e ndërthurur nga brenda në mënyrë që të mund të vlerësohet siç duhet kundrejt kërkesave të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe rregullave kombëtare përkatëse të njoftuara. Organi i certifikimit të sigurisë, në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë, që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit, kryen një rishikim fillestar të përmbajtjes aktuale të provave të përfshira në aplikim për të bërë një gjykim fillestar mbi cilësinë, mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e menaxhimit të sistemit të sigurisë;

c) nëse është e aplikueshme, statusi aktual i planit të veprimit (ose planeve) të krijuar nga sipërmarrja hekurudhore për të zgjidhur çdo mospërputhje të madhe dhe çdo fushë tjetër shqetësimi të identifikuar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes që nga vlerësimi i mëparshëm;

ç) nëse është e aplikueshme, përfshihet statusi aktual i planit të veprimit (ose planeve) të krijuar nga sipërmarrja hekurudhore për të zgjidhur shqetësimet e mbetura nga vlerësimi i mëparshëm.

3.2 Autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit kontrollojnë, gjithashtu, nëse evidenca për llojin, shtrirjen dhe zonën e synuar të operimit është identifikuar qartë.

3.3 Pas kontrolleve të përmendura në pikat 3.1 dhe 3.2, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit vendosin nëse ka zona në të cilat, për pjesën e tyre përkatëse, nevojitet informacion i mëtejshëm. Aty ku nevojiten informacione të mëtejshme, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit mund të kërkojnë menjëherë informacionin, në masën që ata e konsiderojnë të arsyeshme, të nevojshme për të mbështetur vlerësimin e tyre.

3.4 Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit duhet të lexojnë një sasi të mjaftueshme të aplikimit, secili për pjesën e vet, për të kontrolluar nëse përmbajtja e tij është e kuptueshme. Nëse nuk është e qartë, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit do të vendosin, secili për pjesën e vet, nëse duhet të kthehet, me një kërkesë për një version të përmirësuar.

4. VLERËSIMI I DETAJUAR

4.1 Pas përfundimit të fazës fillestare të vlerësimit, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit do të vazhdojnë, secili për pjesën e vet, me vlerësimin e detajuar të dosjes së aplikimit (shih figurën 2 në shtojcën), duke përdorur kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe rregullat përkatëse kombëtare të njoftuara.

4.2 Në ndërmarrjen e vlerësimit të detajuar, të përmendur në pikën 4.1, në përputhje me nenin 71, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit duhet të ushtrojnë gjykimin profesional, të paanshëm dhe proporcional, dhe jep arsye të dokumentuara për përfundimet e arritura.

4.3 Vlerësimi përcakton nëse kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe rregullat përkatëse kombëtare të njoftuara janë përmbushur ose nëse do të kërkohet informacion i mëtejshëm. Gjatë vlerësimit, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit kërkojnë gjithashtu prova që kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe rregullat përkatëse kombëtare të njoftuara janë përmbushur nga rezultatet e proceseve të sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përdorur metodat e krahasimit kur është e përshtatshme, për të siguruar që aplikanti ka kuptuar dhe mund të përmbushë kërkesat, sipas llojit dhe shtrirjes së operacioneve hekurudhore dhe zonës së synuar të operimit, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i sigurt i hekurudhës.

4.4 Çdo çështje e tipit 4 do të zgjidhet me mirëkuptimin e organit të certifikimit të sigurisë dhe do të çojë në një përditësim të dosjes së aplikimit, aty ku është e përshtatshme, përpara se të lëshohet certifikata e vetme e sigurisë.

4.5 Shqetësimet e mbetura mund të shtyhen për shqyrtim në mbikëqyrje, ose veprimet mund të bien dakord me aplikantin, bazuar në propozimin e tij për përditësimin e dosjes së aplikimit, ose të dyja. Në një rast të tillë, zgjidhja formale e çështjes do të bëhet pas lëshimit të certifikatës së vetme të sigurisë.

4.6 Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit duhet të jenë transparente për mënyrën se si ata e gjykojnë ashpërsinë e çdo çështjeje të identifikuar të përmendur në nenin 12, pika 1 të rregullores.

4.7 Kur identifikohet një çështje e përmendur në nenin 12, pika 1, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit duhet të jenë specifike dhe të ndihmojnë aplikantin të kuptojë nivelin e detajeve të pritura në përgjigje. Për këtë qëllim, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit, ndërmarrin hapat e mëposhtëm:

- a) i referohen me saktësi kërkesave përkatëse të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe rregullave kombëtare të njoftuara dhe ndihmojnë aplikantin të kuptojë çështjet e identifikuara;
- b) identifikojnë pjesën përkatëse të rregulloreve dhe rregullave përkatëse;

c) deklarojnë pse nuk përmbushen kërkesat individuale të sistemit të menaxhimit të sigurisë ose rregullit kombëtar të njoftuar, duke përfshirë çdo legjislacion përkatës;

ç) bien dakord me aplikantin për angazhime të mëtejshme, dokumente dhe çdo informacion tjetër mbështetës që do të jepet, siç kërkohet nga niveli i detajeve të kërkesës së sistemit të menaxhimit të sigurisë ose rregullit kombëtar të njoftuar;

d) specifikojnë dhe bien dakord me aplikantin për një afat kohor për pajtueshmërinë, të arsyeshme dhe proporcionale me vështirësinë e dhënies së informacionit të kërkuar.

4.8 Nëse aplikanti vonon ndjeshëm dhënien e informacionit të kërkuar, organi i certifikimit të sigurisë mund të vendosë të zgjasë afatin kohor për përgjigjen e aplikantit ose të refuzojë aplikimin pas njoftimit.

4.9 Afati kohor për marrjen e vendimit për lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë mund të zgjatet, derisa informacioni i kërkuar të jetë dorëzuar, me vendim të organit të certifikimit të sigurisë në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit dhe me marrëveshjen e aplikantit në një nga rastet e mëposhtme:

a) çështjet e tipit 1 të përmendura më sipër që, të konsideruara individualisht ose kolektivisht, pengojnë vazhdimin e vlerësimit ose pjesëve të tij;

b) çështjet e tipit 4 ose çështjet e shumta të tipit 3 të përmendura më sipër që, të konsideruara kolektivisht, mund ta ngrenë kategorinë në një çështje të tipit 4, duke penguar lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë.

4.10 Për të qenë të kënaqshme, përgjigjet me shkrim të aplikantit do të jenë të mjaftueshme për të zbutur shqetësimet e shprehura dhe për të demonstruar se aranzhimet e propozuara do të plotësojnë kriteret përkatëse ose rregullat kombëtare të njoftuara.

4.11 Kur një përgjigje konsiderohet e pakënaqshme, duhet të shpjegohet saktësisht pse, duke identifikuar informacionin ose demonstrimin e mëtejshëm të kërkuar nga aplikanti për ta bërë atë të kënaqshme.

4.12 Nëse lindin shqetësime se aplikimi mund të refuzohet, ose se do të duhet një kohë më e gjatë për të marrë një vendim sesa afati kohor i lejuar për vlerësimin, organi i certifikimit të sigurisë mund të marrë në konsideratë masat e mundshme emergjente.

4.13 Kur arrihet në përfundimin se ose aplikimi i plotëson të gjitha kërkesat ose se progresi i mëtejshëm nuk ka gjasa në sigurimin e përgjigjeve të kënaqshme për çështjet e pazgjidhura, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit, secili për pjesën e vet, duhet të plotësojnë vlerësimin me hapat e mëposhtëm:

a) duke deklaruar nëse të gjitha kriteret janë përmbushur ose nëse ka ende çështje të pazgjidhura;

b) identifikimin e çdo shqetësimi të mbetur;

c) identifikimin e çdo kufizimi ose kushti përdorimi që do të përfshihet në certifikatën e vetme të sigurisë;

ç) raportimin mbi ndjekjen e mospërputhjeve kryesore të identifikuara gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes;

d) duke siguruar që procesi i vlerësimit të sigurisë është zbatuar saktë;

dh) përpilimi i rezultatit të vlerësimit, duke përfshirë konkluzionet përmbledhëse dhe aty ku është e përshtatshme, një opinion në lidhje me lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë.

4.14 Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit regjistrojnë dhe justifikojnë me shkrim të gjitha gjetjet dhe gjykimet në mënyrë që të lehtësojnë si procesin e sigurimit ashtu edhe procesin e vendimmarrjes, si dhe për të ndihmuar me çdo apelim kundër vendimit për lëshimin ose jo të certifikatës së vetme të sigurisë.

5. Vendimmarrja

5.1 Bazuar në përfundimet e vlerësimit përfundimtar, merret një vendim nëse do të lëshohet një certifikatë e vetme e sigurisë ose do të refuzohet aplikimi. Kur duhet të lëshohet një certifikatë e vetme sigurie, mund të identifikohen disa shqetësime të mbetura. Një certifikatë e vetme sigurie nuk do të lëshohet kur ndonjë çështje e tipit 4, si më sipër, identifikohet dhe nuk zgjidhet gjatë vlerësimit.

5.2 Organi i certifikimit të sigurisë mund të vendosë të kufizojë objektin e certifikatës së vetme të sigurisë, duke identifikuar kufizimet ose kushtet e përdorimit, nëse është arritur në përfundimin në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit që këto kufizime ose kushte përdorimi adresojnë çdo çështje të tipit 4, që do të pengonte lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë. Certifikata e vetme e sigurisë do të përditësohet me kërkesë të aplikantit pasi të gjitha shqetësimet e mbetura të jenë adresuar në dosjen e tij të aplikimit.

5.3 Aplikanti duhet të informohet për vendimin e organit të certifikimit të sigurisë, duke përfshirë rezultatin e vlerësimit, dhe një certifikatë e vetme sigurie do të lëshohet sipas rastit.

5.4 Nëse lëshimi i certifikatës së vetme të sigurisë refuzohet ose nëse certifikata e vetme e sigurisë përmban kufizime ose kushte përdorimi të ndryshme nga ato të përcaktuara në aplikim, organi i certifikimit të sigurisë duhet të informojë aplikantin, duke dhënë arsyet e vendimit dhe ta njoftojë atë për procedurën për të kërkuar rishikimin ose ankimimin e vendimit.

6. Vlerësimi përfundimtar

6.1 Organi i certifikimit të sigurisë përfundon mbylljen administrative duke siguruar që të gjitha dokumentet dhe regjistrimet të rishikohen, organizohen dhe arkivohen. Për të përmirësuar vazhdimisht procesin e tij, organi i certifikimit të sigurisë identifikon informacionin historik dhe mësimet e nxjerra për t'u përdorur nga vlerësimet e ardhshme.

7. Dispozitat specifike për rinovimin e një certifikate të vetme sigurie

7.1 Një certifikatë e vetme sigurie mund të rinovohet me kërkesë të aplikantit përpara skadimit të vlefshmërisë së saj për të siguruar vazhdimësinë e certifikimit.

7.2 Në rastin e një aplikimi për rinovim, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë të lidhura me zonën e synuar të operimit kontrollojnë detajet e ndryshimeve në provat e paraqitura në aplikimin e mëparshëm dhe marrin në konsideratë rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të mbikëqyrjes për plotësimin e kërkesave përkatëse të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe rregullat e njoftuara kombëtare mbi të cilat vlerësohet aplikimi i rinovimit.

7.3 Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit do të marrin një qasje proporcionale për rivlerësimin, bazuar në shkallën e ndryshimeve të propozuara.

8. Dispozitat specifike për përditësimin e një certifikate të vetme sigurie

8.1 Një certifikatë e vetme sigurie do të përditësohet sa herë që propozohet një ndryshim thelbësor në llojin ose shtrirjen e funksionimit, në përputhje me nenin 65, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

8.2 Kur synon të bëjë ndonjë ndryshim të përmendur në pikën 8.1, sipërmarrja hekurudhore që zotëron certifikatën e vetme të sigurisë duhet të njoftojë pa vonesë organin e certifikimit të sigurisë.

8.3 Pas njoftimit nga sipërmarrja hekurudhore siç përmendet në pikën 8.2, organi i certifikimit të sigurisë:

a) kontrollon që ndryshimi në lidhje me çdo aplikim të mundshëm është përshkruar qartë dhe që rreziqet e mundshme të sigurisë janë vlerësuar;

b) diskuton me sipërmarrjen hekurudhore dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit nevojën për një përditësim të certifikatës së vetme të sigurisë.

8.4 Organi i certifikimit të sigurisë në koordinim me autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit mund të bëjnë pyetje të mëtejshme me aplikantin. Kur organi i certifikimit të sigurisë bie dakord që ndryshimi i propozuar nuk është thelbësor, ai do të informojë aplikantin me shkrim se nuk kërkohet përditësim, duke mbajtur një procesverbal të vendimit për dosjen e regjistruar.

8.5 Në rastin e një aplikimi të përditësuar, organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që lidhen me zonën e synuar të operimit:

a) kontrollon detajet e ndryshimeve në provat e paraqitura në aplikimin e mëparshëm mbi të cilin është lëshuar certifikata aktuale;

b) merr në konsideratë rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të mbikëqyrjes, siç përmendet, dhe në veçanti, çështjet që kanë të bëjnë me aftësinë e aplikantit për të zbatuar dhe monitoruar në mënyrë efektive procesin e menaxhimit të ndryshimeve;

c) vlerëson kërkesat përkatëse të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe rregullat kombëtare të njoftuara për të vlerësuar aplikimin e përditësimit.


8.6 Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë të lidhura me zonën e synuar të operimit do të marrin një qasje proporcionale për rivlerësimin, bazuar në shkallën e ndryshimeve të propozuara.

8.7 Një kërkesë drejtuar organit të certifikimit të sigurisë për të përditësuar një certifikatë të vetme sigurie nuk do të çojë në zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së saj.

8.8 Organi i certifikimit të sigurisë do të vendosë me kërkesë të aplikantit nëse certifikata e vetme e sigurisë duhet të përditësohet, kur kushtet në të cilat është lëshuar certifikata e vetme e sigurisë duhet të ndryshohen pa ndonjë ndikim në llojin, shtrirjen ose zonën e funksionimit.

SHTOJCA Procesi i vlerësimit të sigurisë

Figura 1. Procesi i vlerësimit të sigurisë




- Regjistri/baza e të dhënave
- Njoftoni palët e interesuara
- Merrni vendim
- Fundi i vlerësimit
- Vlerësimi i ngushtë
- Marrja e vendimit
- Nr.

- Të refuzohet aplikimi?
- Pranoni plotësinë
- Vlerësim i detajuar
- E plotë? E rëndësishme? E vazhdueshme?
- Kërkonte informacion shtesë
- Jepni informacion shtesë
- Kërkesë për shqyrtim/apelimi (aty ku është e nevojshme)
- Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë
- Po
- Vlerësimi fillestar
- Konfirmimi marrjen e aplikimit
- Vendosni skedarin e regjistruar
- Merrni aplikimin
- Paraqisni dosjen e aplikimit
- Aplikanti
- Nr.
- Po
- Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit

Procesi i detajuar i vlerësimit

Figura 2. Procesi i detajuar i vlerësimit



Shqetësimet e mbetura aty ku është e rëndësishme
Plotësoni vlerësimin
Merrni dhe menaxhoni përgjigjen me shkrim të aplikantit
Dërgoni një përgjigje dhe përditësoni skedarin e aplikimit sipas nevojës
Bini dakord për planin(et) e veprimit dhe kornizën kohore për pajtueshmërinë sipas rastit
Vendosni planin(et) e veprimit sipas rastit
Identifikoni dhe kategorizoni çështjet
Informacioni përkatës nga mbikëqyrja e kaluar
Çështjet?
Ndërmerr një vlerësim
Organi i certifikimit të sigurisë dhe autoritetet kombëtare të sigurisë që kanë të bëjnë me zonën e synuar të operimit

Aplikanti
Nr.
Po

ANEKS III Përmbajtja e certifikatës së vetme të sigurisë

Certifikata e vetme e sigurisë që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore, duke përfshirë dispozitat e miratuara nga sipërmarrja hekurudhore, për të përmbushur kërkesat specifike të nevojshme, për funksionimin e sigurt në rrjetin përkatës, në përputhje legjisllacionin kombëtar në fuqi, duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

1. Numri i Identifikimit Evropian (EIN) i certifikatës së vetme të sigurisë

2. Identifikimi i ndërmarrjes hekurudhore:

- 2.1 Emërtimi ligjor
- 2.2 Numri kombëtar i regjistrimit
- 2.3 Numri i TVSH-së

3. Identifikimi i organit të certifikimit të sigurisë:

- 3.1 Organizimi
- 3.2 Shteti anëtar (aty ku është e aplikueshme)

4. Informacioni i certifikatës:

- 4.1 I ri
- 4.2 Rinovim
- 4.3 Përditësim
- 4.4 EIN e certifikatës së mëparshme (vetëm në rast rinovimi ose përditësimi)
- 4.5 Datat e fillimit dhe mbarimit të vlefshmërisë

4.6 Lloji i funksionimit

- 4.6.1 Transporti i pasagjerëve duke përfshirë shërbimet me shpejtësi të lartë
- 4.6.2 Transporti i pasagjerëve me përjashtim të shërbimeve me shpejtësi të lartë
- 4.6.3 Transport mallrash duke përfshirë shërbimet e mallrave të rrezikshme
- 4.6.4 Transport mallrash me përjashtim të shërbimeve të mallrave të rrezikshme
- 4.6.5 Vetëm devijimi
- 4.6.6 Operacione të tjera

5. Legjisllacioni kombëtar i zbatueshëm

6. Zona e veprimit

7. Kufizimet dhe kushtet e përdorimit

8. Informacion shtesë

9. Data e lëshimit dhe nënshkruesi/vula e autorizuar e autoritetit